



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01 - Nr. 16-4961/14
Kaçanik; 28.02.2014

Në bazë të nenit 5, 12.1 dhe 12.2 dhe 40.2(a,g) dhe 17 të Ligjit nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 16 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61. të Statutit të Komunës së Kaçanikut, si dhe nenit 15.1(a) të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28.02.2014, aprovoj;

RREGULLORE
PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01Nr. 05-4236/10
PËR PAGESËN E TARIFAVE DHE NGARKESAVE ADMINISTRATIVE DHE
SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

I.

Me këtë Rregullore bëhet ndryshim plotësimi i nenit 9, të Rregullores për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale, 01Nr. 05-4236/10.

II.

Nenit 9 i shtohet pika 9.1.11 Për Lirimin nga Taksat dhe Ngarkesat për Leje Ndërtimi, të këtyre objekteve:

Objektet e banimit (të kategorisë së parë), që për qëllim kanë vendosjen e një familje të dëshmorëve (sipas të drejtave të familjarëve që ua njeh ligji për këto kategori),

Objektet e banimit (të kategorisë së parë), të cilat për qëllim strehimi i ndërtohen një familje nga ndonjë organizatë humanitare apo nga ndonjë institucion tjetër zyrtar për qëllime humanitare,

Objektet të cilat shfrytëzohen për qëllime bujqësore për personat të cilët janë të subvencionuar nga ndonjë institucion zyrtar, për zhvillimin e bujqësisë.

III

Për zbatimin e Rregullores kujdesen; Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

IV.

Kjo Rregullore me miratimin e saj nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL-së si dhe Publikimit në Faqen Zyrtare të komunës së Kaçanikut.



Kryesuesi i kuvendit,
Xhelal Gashi